Врз основа на член 55 став 1 од Законот за организација и работа на органите на државната управа („Службен весник на Република Македонија" бр. 58/00, 44/02, 82/08,167/10 и 51/11) и член 22 став 1 од Законот за средното образование („Службен весник на Република Македонија" бр. 44/95, 24/96, 34/96, 35/97, 82/99, 29/02, 40/03, 42/03, 67/04, 55/05, 113/05, 35/06, 30/07, 49/07, 81/08, 92/08, 33/10, 116/10, 156/10, 18/11, 42/11, 51/11, 6/12, 100/12, 24/13, 41/14, 116/14, 135/14, 10/15, 98/15, 145/15, 30/16, 127/16, 67/17 и 64/18), министерот за образование и наука ја донесе наставната програма по наставниот предмет ***ликовна уметност*** за I (прва) година образование од средното стручно образование со четиригодишно траење.

MINISTRIA E ARSIMIT DHE E SHKENCËS
BYROJA PËR ZHVILLIMIN E ARSIMIT

Programi mësimor

# ARTI FIGURATIV

dizajn modular

për vitin I

*të gjitha profilet arsimore/kualifikimet*

*të gjitha drejtimet/sektorët*

Shkup, viti 2019

| | |
|---|---|
| **Titulli i programit mësimor** | Arti figurativ |
| **Lloji i programit mësimor** | I obligueshëm |
| **Vlera kreditore e programit mësimor** | 2 (dy) kredi ECVET [1] |
| **Drejtimi** | Të gjitha drejtimet |
| **Sektori** | Të gjitha drejtimet |
| **Profili arsimor** | Të gjitha profilet arsimore |
| **Titulli dhe niveli i kualifikimit** | Të gjitha kualifikimet<br><br>Niveli 4 (i katërt) |
| **Viti shkollor** | Viti I (i parë) |
| **Numri i orëve në javë/vit për realizimin e programit mësimor** | 1 / 36 |
| **Qëllimet e programit mësimor** | Qëllimet e programit mësimor në **artin figurativ** janë që nxënësi/nxënësja:<br>- të zhvillojë aftësi për perceptim të drejtë vizual dhe të dijë të dallojë vlerat artistike dhe estetike të veprave të artit figurativ dhe të arteve dhe shprehjeve tjera vizuale;<br>- të përvetësojë njohuri themelore teorike dhe nocione nga fusha e teorisë së artit figurativ;<br>- të zhvillojë shkathtësi të të shprehurit kreativ nëpërmjet shprehjeve të ndryshme artistike dhe shfrytëzojë teknika tradicionale dhe bashkëkohore;<br>- të zhvillojë mendim dhe shprehej kreative nëpërmjet realizimit të veprave artistike dhe projekteve më zbatimin |

[1] Ligji për Kornizën nacionale të kualifikimeve.

| | |
|---|---|
| | e diturisë teorike të fituara;<br>- të njihet me rolin, lidhjen dhe integrimin e arteve vizuale me të gjitha fushat e jetës së përditshme; |
| **Njësitë modulare të programit mësimor** | 1. ZHVILLIMI I ARTIT FIGURATIV<br>2. KRIJIMTARIA DHE SHPREHJA E ARTIT FIGURATIV<br>3. DIZAJNI DHE KOMUNIKIMET VIZUELE<br>4. SHPREHJA MULTIMEDIALE |
| **Kushtet materiale-teknike dhe hapësinore** | Për arritje të qëllimeve të programit mësimor në **artin figurativ** nevojitet: kabineti (klasa e adoptuar për atelie të artit figurativ), ndriçimi adekuat natyror dhe artificial, instalim adekuat i ujësjellësit, kushtet adekuate hapësinore për ruajtjen e materialeve dhe dëshmive të artit figurativ, TIK pajisje, interneti, LCD projektori, fotoaparati, presa grafike (format i vogël), sigurimi i veglave themelore të artit figurativ, materiale, mjete dhe literatura adekuate shkencore (enciklopedi, monografi, revista etj.) dhe mjete konkrete. |
| **Normativi i kuadrit mësimor** | Programin mësimor e realizojnë arsimtarët me studime të kryera të **artit figurativ** (drejtimi arsimor ose drejtim tjetër, me përgatitje pedagogjike-psikologjike dhe metodike ose me kualifikim plotësues pedagogjik nga ndonjë institucion i akredituar për arsim të lartë), VII/1 ose VIA sipas KNK dhe 240 ECTS. |

| | Njësia modulare 1: ZHVILLIMI I ARTIT FIGURATIV (përafërsisht 5 orë) | | | |
|---|---|---|---|---|
| **Nr. rendor** | **Rezultatet nga të mësuarit** | **Përmbajtjet dhe nocionet** | **Aktivitetet dhe metodat** | **Kriteret e vlerësimit*** |
| 1 | **Nxënësi/nxënësja do të jetë i aftë të:**<br>- dallojë ndarjen e arteve figurative (fushat e artit-shprehjet dhe veprat e artit) nga arti i aplikuar (dizajni dhe arkitektura); | **Kultura e artit figurativ**<br><br>Nocionet:<br>- Vizatimi-vizatim<br>-Pikturimi-piktura<br>-Grafika<br>-Skulpturimi-skulptura<br>-Dizajni<br>-Arkitektura | **Aktivitetet:**<br>-Prezantimi i shembujve të veprave të artit figurativ nga gjitha fushat<br>-Prezantimi dhe sqarimi i shembujve për rolin e zbatimit të artit dhe arkitekturës<br>-Dëgjimi i fragmenteve adekuate muzikore<br><br>**Metodat:**<br>-Demonstrimi<br>-Hulumtimi<br>-Prezantimi<br>-Diskutimi<br>-Puna grupore dhe individuale | **Nxënësi/nxënësja mund të:**<br>1.1.1 definojë nocionet: vepër e artit figurativ (vizatim, pikturë, grafikë, skulpturë), arkitekturë dhe dizajn<br>1.1.2. njohë funksionin e artit të aplikuar<br>1.1.3. bëjë dallim mes fushave të artit, veprave të artit dhe shprehjeve të artit |
| 2 | - njohë dhe dallojë karakteristikat themelore të periudhave, stileve dhe drejtimeve të zhvillimit të artit figurativ/vizual; | **Zhvillimi i artit figurativ**<br><br>Nocionet:<br>-Arti parahistorik<br>-Arti mesjetar<br>-Renesanca<br>-Baroku, Klasicizmi, Realizmi<br>-Arti modern (drejtimet e shekullit 20)<br>-Zhvillimi artit maqedonas dhe | **Aktivitetet:**<br>- Analizimi dhe diskutimi për veprat artistike të periudhave, stileve dhe drejtimeve<br>- Përpunimi i hulumtimeve dhe projekteve për periudha, stile dhe drejtime të caktuara ose artistë<br>-Vizita e ekspozitës, galerisë, ateliesë etj., në bazë të mundësive | 1.2.1. ndajë karakteristikat kryesore të periudhave, stileve dhe drejtimeve të caktuara<br>1.2.2 njohë vepra më të rëndësishme të artit figurativ dhe përfaqësuesit e periudhave, stileve dhe drejtimeve të caktuara |

* Janë vendosur standarde/indikatorë për arritjen e rezultateve nga të mësuarit në bazë të të cilave përcaktohen kriteret e vlerësimit.

| | | | | |
|---|---|---|---|---|
| | | përfaqësuesit më të rëndësishëm | **Metodat:**<br>-Prezantimi<br>-Biseda<br>-Analiza dhe sinteza<br>-Hulumtimi<br>-Puna grupore dhe individuale<br>-Mësimi me anë të vëzhgimit<br>- Analiza estetike e veprave të artit figurativ | 1.2.3. prezantojë veprat e artistëve të njohur dhe punimet e nxënësve |

| | Njësia modulare 2: KRIJIMTARIA DHE SHREHJA E ARTIT FIGURATIV (përafërsisht 12 orë) | | | |
|---|---|---|---|---|
| **Nr. rendor** | **Rezultatet nga të mësuarit** | **Përmbajtjet dhe nocionet** | **Aktivitetet dhe metodat** | **Kriteret e vlerësimit** * |
| | | 2.1 VIZATIM (2 orë) | | |
| 1 | **Nxënësi/nxënësja do të jetë i aftë të:**<br>- dallojë dhe krijojë lloje të ndryshme të vizatimeve me përdorimin e llojeve të ndryshme të vijave, perspektivën, raportet e ndritshme-e errët. | -Llojet e vizatimeve, teknikat e vizatimit, materiali dhe karakteristikat e tyre<br>-Elementet e artit figurativ dhe parimet në vizatim<br><br>**Nocionet:**<br>-Skica<br>-Plane<br>-Studime<br>-Vizatim me kolazh<br>-Vizatim koloristik<br>-Vij, llojet e vijave<br>-Perspektiva dhe llojet e perspektivave<br>-Shkallëzimi akromatik tonik (e ndritshme-e errët) | **Aktivitetet:**<br>-Krijimi i vizatimit me teknikën sipas zgjedhjes<br>-Shfrytëzimi i llojeve të ndryshme të vijave me intensitet dhe karakter të ndryshëm<br>-Hulumtimi dhe prezantimi i llojeve të ndryshme të perspektivave<br>-Eksperimentimi me procedurat e ndryshme vizatuese<br><br>Metodat:<br>-Demonstrimi<br>-Vëzhgimi<br>-Diskutimi<br>-Puna individuale<br>-Hulumtimi<br>-Prezantimi<br>-Puna grupore dhe individuale<br>-Puna praktike | **Nxënësi/nxënësja mund të:**<br>2.1.1.1. numërojë llojet e vizatimit<br>2.1.1.2 zbatojë teknikat dhe procedurat e ndryshme të vizatimit<br>2.1.1.3 krijojë vepër të artit figurativ me zbatimin e: llojeve të vijave, perspektivave dhe raporteve e ndritshme-e errët |

* Janë vendosur standarde/indikatorë për arritjen e rezultateve nga të mësuarit në bazë të të cilave përcaktohen kriteret e vlerësimit.

| | 2.2 PIKTURIMI (4 orë) | | | |
|---|---|---|---|---|
| 1 | **Nxënësi/nxënësja do të jetë i aftë të:**<br>- përdorë ngjyrat themelore, sekondare, mes ngjyrat, terciare dhe tonet e tyre; | -Ndarja në ngjyra themelore, sekondare, mes ngjyra,terciare dhe tonet e tyre<br>- 3D hapësirë dhe iluzion i hapësirës 3D në bazë 2D<br><br>**Nocionet:**<br>- Përzierja e ngjyrave<br>- Ngjyrat themelore<br>- Ngjyrat sekondare<br>- Mes ngjyrat<br>- Ngjyrat terciare<br>- Shkallëzimi kromatik tonik<br>- Hapësira | **Aktivitetet:**<br>-Përzierja e ngjyrave dhe fitimi i ngjyrave sekondare, mes ngjyrave, terciare dhe tonet e tyre<br>- Prezantimi i iluzionit të hapësirës me përdorim të ngjyrave të ndryshme dhe toneve të tyre<br>**Metodat:**<br>-Demonstrimi<br>-Vëzhgimi<br>-Diskutimi<br>-Hulumtimi<br>-Puna individuale<br>-Puna praktike | **Nxënësi/nxënësja mund të:**<br><br>2.2.1.1. bëjë dallim mes ngjyrave themelore, mes ngjyrave, sekondare dhe terciare<br>2.2.1.2. krijojë iluzion të hapësirës me ngjyra dhe tone |
| 2 | - dallojë, shfrytëzojë dhe eksperimentojë me materiale dhe teknikat e ndryshme të pikturimit. | - Njohuritë themelore për materialet dhe teknikat standarde të pikturimit<br>- Njohuritë themelore për procedurat jostandarde të pikturimit dhe teknikat e kombinuara<br><br>**Nocionet:**<br>-Materialet dhe teknikat e pikturimit<br>- Kompozicioni piktoral<br>- Teknikat standarde të pikturimit<br>-Procedurat jostandarde të pikturimit<br>-Teknikat e kombinuara | -Njohja e llojeve të materialeve dhe teknikave të pikturimit<br>-Shfrytëzimi, kombinimi dhe komponimi me lloje të ndryshme të materialeve dhe teknikave të pikturimit<br>**Metodat:**<br>-Demonstrimi<br>-Vëzhgimi<br>-Diskutimi<br>-Hulumtimi<br>-Prezantimi<br>-Puna grupore dhe individuale<br>-Mësimi nëpërmjet punës praktike<br>-Analiza | 2.2.2.1. njohë llojet e materialeve dhe teknikave të pikturimit<br>2.2.2.2. komponojë elemente të artit figurativ dhe krijojë kompozicione |

| | | | | |
|---|---|---|---|---|
| | 2.3 GRAFIKA (3 orë) | | | |
| 1 | **Nxënësi/nxënësja do të jetë i aftë të:**<br>-dallojë vulën e lartë, thellë, rrafshët dhe lëshuese, unike dhe multiorigjinale dhe grafikën digjitale. | -Njohuritë themelore për grafikën dhe llojet e teknikave të grafikës<br>-Procedurat themelore për përgatitjen dhe krijimin e veprës grafike<br>-Procesi i krijimit të veprës grafike nga skica e gjurmës (teknika sipas zgjedhjes)<br><br>**Nocionet:**<br>-Teknikat grafike (e lartë, e thellë, e rrafshët dhe lëshuese)<br>-Matrica/pllaka grafike<br>-Gjurma grafike/fleta | **Aktivitetet:**<br>-Njohja e karakteristikave themelore mes teknikave të veçanta grafike<br>-Krijimi i skicës dhe matricës për krijim grafik me shfrytëzimin e mjeteve dhe veglave për përpunimin e krijimit personal grafik me teknikën e zgjedhur.<br><br>**Metodat:**<br>-Demonstrimi<br>-Vëzhgimi<br>-Diskutimi<br>-Hulumtimi<br>-Prezantimi<br>-Puna grupore dhe individuale<br>-Puna praktike | **Nxënësi/nxënësja mund të:**<br><br>2.2.3.1 numërojë teknikat grafike<br>2.2.3.2 identifikojë ç'është matrica dhe gjurma grafike<br>2.2.3.3 krijojë matricë sipas skicës |
| | 2.4 Formësimi i hapësirës-SKULPTURA (2 orë) | | | |
| 1 | **Nxënësi/nxënësja do të jetë i aftë të:**<br>- dallojë llojet e skulpturës. | -Llojet e skulpturës dhe karakteristikat e tyre<br>-Teknikat e skulpturës<br>-Njohuritë themelore për hapësirën si mjet për formësim dhe shprehje<br><br>**Nocionet:**<br>-Forma (gjeometrike dhe organike)<br>-Baraspesha<br>-Skulptura galerike, miniature dhe monumentale | -Dallimi dhe analiza e llojeve të skulpturave dhe karakteristikat e tyre<br>-Njohja dhe dallimi i materialeve dhe teknikave të skulpturës<br>- Dallimi i instalacionit artistik dhe intervenimit në hapësirë nga skulptura klasike<br>- Përpunimi i veprës tri dimensionale me materialin sipas zgjedhjes | **Nxënësi/nxënësja mund të:**<br>2.2.4.1 numërojë teknikat e skulpturës<br>2.2.4.2 dallojë instalacionin në hapësirë nga skulptura klasike<br>2.2.4.3 përpunimi i veprës sipas idesë ose detyrës së dhënë |

| | | | | |
|---|---|---|---|---|
| | | -Reliefi (i ulët, i lartë, bas)<br>-Instalacioni artistik<br>-Ambalazhi | **Metodat:**<br>-Demonstrimi<br>-Vëzhgimi<br>-Diskutimi<br>-Hulumtimi<br>-Puna grupore dhe individuale<br>-Puna praktike | |

| | Njësia modulare 3: DIZAJNI DHE KOMUNIKIMET VIZUELE (përafërsisht 12 orë) | | | |
|---|---|---|---|---|
| **Nr. rendor** | **Rezultatet nga të mësuarit** | **Përmbajtjet dhe nocionet** | **Aktivitetet dhe metodat** | **Kriteret e vlerësimit*** |
| 1 | **Nxënësi/nxënësja do të jetë i aftë të:**<br>- dallojë llojet e dizajnit, gjegjësisht llojet e komunikimeve vizuale; | -Hyrja në komunikimet vizuale<br>- Gjuha vizuale (elementet, shenjat dhe simbolet)<br>-Llojet e dizajnit<br><br>**Nocionet:**<br>-Arti i aplikuar<br>(dizajni grafik,<br>Dizajni industrial, komunikimet vizuale)<br>-Gjuha vizuale (elementet, shenjat dhe simbolet) | **Aktivitetet:**<br>- Sqarimi i zbatimit të elementeve, shenjave dhe simboleve vizuale, si mjet për komunikim<br>- Njohja dhe sqarimi i llojeve të ndryshme të dizajnit<br>- Diskutimi për nevojën e dizajnit dhe komunikimeve vizuale në tregti dhe sipërmarrësi (p.sh. ftesa e personit profesionist në lëmin e vet) | **Nxënësi/nxënësja mund të:**<br>3.1.1. definojë ç'është komunikimi vizual<br>3.1.2. identifikojë llojet e dizajnit<br>3.1.3 përkufizojë cili është zbatimi praktik i dizajnit |

* Janë vendosur standarde/indikatorë për arritjen e rezultateve nga të mësuarit në bazë të të cilave përcaktohen kriteret e vlerësimit.

| | | | | |
|---|---|---|---|---|
| | | | **Metodat:**<br>-Diskutimi<br>-Interaksioni<br>-Prezantimi<br>-Puna individuale dhe grupore<br>-Analiza e shembujve | |
| 2 | - sqarojë zbatimin dhe karakteristikat e dizajnit grafik; | -Nocioni për dizajnin grafik<br>-Elementet dhe mjetet shprehëse të dizajnit grafik<br>-Zbatimi praktik i produkteve të dizajnit grafik<br><br>**Nocionet:**<br>-Logo<br>-Afishe<br>-Pllakate<br>-Ftesa në eveniment<br>-Bilborde<br>-Ilustrime<br>-Ambalazhe | **Aktivitetet:**<br>- Sqarimi i nevojës dhe zbatimit të dizajnit grafik<br>- Njohja dhe numërimi i produkteve që janë lëndë e dizajnit grafik<br>- Përpunimi dhe prezantimi i skicave dhe planeve për zgjidhjet grafike për prodhimin e caktuar, ndërmarrjen, kompaninë etj.<br>- Vizita e studios grafike dhe shtypshkronjës, sipas mundësive<br><br>**Metodat:**<br>-Diskutimi<br>-Interaksioni<br>-Demonstrimi<br>-Puna individuale<br>-Puna në grupe<br>-Analiza e shembujve | 3.2.1. numërojë prodhime që janë lëndë e dizajnit grafik<br>3.2.2. sqarojë cili është roli dhe efekti i dizajnit grafik<br>3.2.3. krijojë zgjidhje ideore për dizajnin grafik |
| 3 | - sqarojë zbatimin dhe karakteristikat e dizajnit industrial; | -Nocioni dhe karakteristikat e dizajnit historik<br><br>**Nocionet:** | **Aktivitetet:**<br>-Njohja dhe numërimi i shembujve, gjegjësisht prodhimeve nga dizajn industrial | 3.3.1. numërojë prodhime të cilat janë lëndë e dizajnit industrial<br>3.3.2. sqarojë cili është roli |

| | | | | |
|---|---|---|---|---|
| | | - Dizajni industrial<br>- Dizajni i makinave dhe automjeteve<br>- Dizajni i mobilieve<br>- Dezeni<br>- Dizajni i tekstilit dhe veshmbathjes<br>-Dizajni i ornamenteve, stolive dhe aksesorëve tjerë të modës | -Diskutimi për nevojën e dizajnit industrial<br>-Përpunimi dhe prezantimi i skicës dhe planit për zgjidhje ideore për prodhim industrial të caktuar, ambalazhin dhe funksionin e tij<br><br>**Metodat:**<br>-Diskutimi<br>-Interaksioni<br>-Prezantimi<br>-Puna individuale dhe grupore<br>-Evaluimi<br>- Analiza | dhe ndikimi i dizajnit industrial në jetën e përditshme<br>3.3.3. përpunojë zgjidhje ideore dhe dizajn për prodhime të caktuara industriale |
| 4 | - sqarojë përdorimin dhe karakteristikat e dizajnëve specifikë gjegjësisht llojeve unike të dizajnit. | -Dallimet mes dizajnit serik dhe unik<br><br>**Nocionet:**<br>-Kostumografia<br>-Skenografia<br>-Stripi<br>-Grafiti<br>-Dizajni i modës | **Aktivitetet:**<br>-Njohja dhe numërimi i inovacioneve të cilët janë lëndë e dizajnit unik<br>-Prezantimi i skicave dhe planeve për zgjidhje ideore për dizajn unik<br>- Vizita e teatrit, ateliesë kostumografike etj., sipas mundësive<br><br>**Metodat:**<br>-Diskutimi<br>-Interaksioni<br>-Prezantimi<br>- Puna individuale dhe grupore<br>-Luajtja e roleve<br>-Analiza | 3.4.1. sqarojë ç'është dizajni unik<br>3.4.2. krijojë zgjidhje ideore për dizajnin unik |

| | Njësia modulare 4: SHPREHJA MULTIMEDIALE (përafërsisht 7 orë) | | | |
|---|---|---|---|---|
| **Nr. rendor** | **Rezultatet nga të mësuarit** | **Përmbajtjet dhe nocionet** | **Aktivitetet dhe metodat** | **Kriteret e vlerësimit*** |
| 1 | **Nxënësi/nxënësja do të jetë i aftë të:**<br>- njohë nocionet themelore në lëmin e shprehjes multimediale; | -Hyrja në nocioni shprehje multimediale<br>-Njohuritë digjitale<br><br>**Nocionet:**<br>- Njohuritë digjitale (veglat)<br>- Video arti | **Aktivitetet:**<br>-Sqarimi i nevojës dhe karakteristikat e shprehjes multimediale nëpërmjet shembujve<br>-Sqarimi i nevojës dhe karakteristikat e shprehjes multimediale<br>**Metodat:**<br>-Diskutimi<br>-Interaksioni<br>-Demonstrimi<br>- Puna individuale dhe grupore<br>-Analiza | **Nxënësi/nxënësja mund të:**<br><br>4.1.1. numërojë veglat për krijimin e veprës multimediale<br>4.1.2. sqarojë ç'është vepra multimediale<br>4.1.3. zbatoje softuer dhe aplikacion për përpunimin e videos<br>(sipas zgjedhjes së nxënësit/nxënëses) |
| 2. | - krijojë krijim multimedial; | **Nocionet:**<br>- Fotografia<br>-Video-klipi<br>-Animacioni<br>-Skenari<br>-Produksioni | **Aktivitetet:**<br>-Nxitja e shprehjes kreative (me fotoaparat digjital, kompjuter personal-program adekuat, tablet, telefon të mençur etj.)<br>- Krijimi i fotografisë ose video-klipi me aplikacion të thjeshtë softuerik (sh. Telefoni celular)<br>- Krijimi i veprës me kombinimin e | 4.2.1. modifikojë fotografi me mjete nga aplikacioni mobil<br>4.2.2. komponojë/kombinojë fotografinë dhe tekstin<br>4.2.3. Krijojë mini video-klip |

* Janë vendosur standarde/indikatorë për arritjen e rezultateve nga të mësuarit në bazë të të cilave përcaktohen kriteret e vlerësimit.

| | | | | |
|---|---|---|---|---|
| | | | fotografisë me tekstin<br>-Krijimi i skenarit dhe incizimi i mini video-klipeve<br><br>**Metodat:**<br>-Interaksioni<br>-Demonstrimi<br>-luajtja e roleve<br>- Puna individuale dhe grupore<br>- Analiza | |

| | |
|---|---|
| **Vlerësimi i arritjeve të nxënësve** | Përcjellja dhe vlerësimi i arritjeve të nxënësve, duhet të bëhet sipas planit, në mënyrë sistematike dhe në vazhdimësi gjatë gjithë vitit shkollor.<br>Gjatë mësimit rregullisht të përcillen dhe vlerësohen arritjet e nxënësve, të mbahet evidencë për detyrat, aktiviteteve dhe motivimin e tyre gjatë orëve si dhe bashkëpunimin e tyre kolektiv etj. (vlerësimi formativ).<br>Të ndiqet zhvillimi i nxënësit, shkathtësitë e tij të përfituara, si dhe zgjidhjet kreative të fituara nëpërmjet realizmit të detyrave të dhëna si pjesë e punës praktike, nëpërmjet projekteve individuale dhe grupore.<br>Nxënësi të zbatojë vetëvlerësimin e arritjeve të veta.<br>Për kontroll të nivelit të arritur të njohurisë teorike, të shfrytëzohen procedurat vijuese: kontrolli nëpërmjet diskutimeve, bisedave, prezantimeve dhe kontrollit të njohurive nëpërmjet testeve.<br>Rregullisht të vlerësohet niveli i arritur i njohurive praktike dhe teorike sipas moduleve, gjatë gjithë vitit shkollor.<br>Arritjet e nxënësve të vlerësohen me notë numerike (notim përmbledhës) për secilin tremujor, së paku dy herë në një gjysmëvjetor, ndërsa përfundohen notat e gjysmëvjetorit dhe ajo vjetore<br>Arsimtari vazhdimisht ta informojë nxënësin për nivelin e rezultateve të arritura në mësimin teorik dhe praktik. |
| **Literatura dhe burimet e tjera** | Teksti/tekstet mësimore të miratuara nga Ministria e Arsimit dhe Shkencës, si dhe burime tjera për mësim. |
| **Fillimi i zbatimit të Programit mësimor** | Viti shkollor 2019/2020 |
| **Institucioni/<br>Bartësi i programit** | Byroja për Zhvillimin e Arsimit (BZHA) |

| | |
|---|---|
| Потпис и датум на донесување на наставната програма | бр. 13-4390/19<br>11.6.2019 година<br><br>МИНИСТЕР, с.р.<br>Dr. Arbër Ademi |
| Датум на ревизија | |